

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo




Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Južne Mitrovica - Municipality of Mitrovica South

Drejtoria Për Mirëqenie Sociale

Raporti i Punës
Janar – Qershor 2024



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës Jugore
Opština Južna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

DREJTORIA PËR MIRËQENIE SOCIALE

Raporti i punës për Periudhën Janar – Qershor 2024

1) Sektori për Mirëqenie Sociale dhe Strehim

Sektori për Mirëqenie Sociale dhe Strehim, aktivitetet e punës i mbështet në dispozitat ligjore të Republikës së Kosovës të cilat e rregullojnë lëminë e Mirëqenies Sociale dhe të strehimit.

Drejtoria për Mirëqenie Sociale duke u mbështetur në të dhënat në dispozicion dhe gjendjen reale në terren, konsideron se numri i kërkesave për ndihma ushqimore –higjienike, strehim, pagesën e qirave të banimit, është i arsyeshëm.

Gjatë periudhës kohore Janar – Qershor 2024, kemi pranuar 173 kërkesa të ndryshme

Për pako ushqimore 125 nga te cilat 90 janë pozitive, 32 negative (raste jo sociale dhe me anëtare te punësuar) dhe 3 ne proces.

Kërkesa për ndihme financiare per OJQ-te 20 raste prej të cilave 12 janë pozitive dhe 8 negative,

Kërkesa për qira 25 nga te cilat 15 janë pozitive dhe 10 janë negative (ne mungese te kontratave valide)

Nje kërkesë për strehim.

Kërkesa te ndryshme janë 2, njëra është pozitive dhe njëra negative.

Ne total 118 kërkesa janë aprovuar – pozitive, 52 janë refuzuar – negative 3 janë mbetur në proces.

Gjatë periudhës kohore Janar – Qershor 2024, (përveç kërkesave nga viti paraprak), kemi pasur një kërkesë të paraqitur për strehim/ banim social nga një familje që ka kërkuar strehim momental/

zgjidhje të banimit. (familjari është refuzuar nga Komisioni i DMS për shkak të mos plotësimit të dispozitave ligjore)

Gjatë periudhës kohore Janar – Qershor 2024, janë realizuar projekte dhe veprime punuese si në vijim:

Mbështetja financiare për periudhën kohore Janar – Qershor 2024 në pagesën e qirasë për 15 familje (tri familje nga pjesa Veriore e Mitrovicës) me **shumë totale 10,644.34 €**. Pas aplikimit të kërkesave së këtyre familjeve në Drejtorinë e Mirëqenies Sociale, Komisioni ka bërë verifikimin e dokumentacionit si dhe paraprakisht janë realizuar vizitat e familjeve në fjalë.

Drejtoria për Mirëqenie Sociale ka bërë thirrjen publike për vitin 2024 për OJQ-të që ndërlidhen me punën e DMS-së me numër protokollit : 01-453/01-0026249-2/24 data 19.04.2024 . Si dhe përzgjedhjen nga Komisioni i caktuar për 11 OJQ-të përfituese në **vlerë prej 11.000.00 € (euro)**.

Më 08.03.2024, është nënshkruar Marrëveshja një vjeqare për Kryerjen e Shërbimeve dhe Ceremonive Fetare në mes të BIK-ut dhe Komunës së Mitrovicës së Jugut për pagesën e shpenzimeve të varrimit për qytetarët e Mitrovicës së Jugut me numër të Protokollit 01-352/05-0017665/24 e datës 08.03.2024.

Janë kompletuar raportet dhe Faturat dhe janë kryer pagesat e shërbimeve të varrimit- borxhet për muajin Tetor, Nëntor dhe Dhjetor të vitit 2023, dhe janë ekzekutuar në vlerën **prej 40,675.00 € (katërdhjetë mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e pesë euro)**;

Po ashtu janë ekzekutuar pagesat e varrimit për muajt: Janar, Shkurt, Mars, dhe Maj 2024 në shumë totale 54.710.00 € (pesdhjetë e katermijë e shtatëqind e dhjetë euro). Jane mbetur borxh I pa paguar për muajin Prill dhe Qershor. 23.470.00 euro (njetzet e tre mij e katerqind e shtatë dhjetë euro).

Pagesa e 30.000 (Tridhjetë mijë Eurove) për familjen Brahimi në fshatin Kçiq, e cila ka pësuar fatkeqësi nga zjarri. Vendimi është miratuar nga Kuvendi Komunal i Mitrovicës së Jugut. Nr. 02-060/01-0005239-5/24 data 31.01 2024.

Gjatë periudhës kohore Janar – Qershor 2024, është Nënshkrimi i Bashkëpunimit me CBM për vazhdimin ndertimit të Strehimorës në fshatin Frashër. Nr. protokoli 16-030/05-0032286/24 data 13.05.2024.

Nënshkrimi i Memorandum mirëkuptimi në mes të Drejtorisë për Mirëqenie Sociale në Istog dhe DMS-së, Mitrovicë e Jugut për bashkëpunim ndërkomunal për shkëmbimin e përvojave dhe aktiviteteve të përbashkëta për përkrahjen e moshës së tretë numer protokoli 16-030/01-0025095/24 data 11.04.2024.

Nënshkrimi i Memorandumit të Mirëkuptimit në shkurt të vitit 2024, me QKRMT-në (Qendra e Kosovës për Rehabilitimin e të Mbijeturave të Torturës), numer 16-030/01-0025125/24 data 19.04.2024. Ky projekt dy vjeçar ofron shërbime të psikologut dhe perfaqësuesit Ligjor pa pagesë për të mbijeturat e torturës, rehabilitimi dhe re-integrimi i të miturave – viktimat të dhunës seksuale në Kosovë. Kjo do bëhet përmes mbështetjes psikologjike dhe zyrtarëve ligjorë, si dhe fuqizimi i kapaciteteve të institucioneve shtetërore të mbështetur nga Ambasada Britaneze.

Nënshkrimi i Memorandumit të bashkëpunimit me Qatar Charity në shkurt të vitit 2024 për 250 pako ushqimore numer 16-550/01-0010398/24 data 09.02.2024, dhe te 500 pako ushqimore nga nga Ambasada e Qatarit ne Tirane.

Nënshkrimi i Memorandumit të bashkëpunimit me Ambasadën e UAE, Podgoricë, në mars 2024, për 250 pako ushqimore. Numer protokoli 16-550/01-0021536/24 data 26.03.2024.

Nënshkrimi i Memorandumit të bashkëpunimit me Qatar Charity Janar – Qershor 2024 për pako ushqimore, mish kurban për 60 familje. Numer 16-030/01-0040507/24 data 14.06.2024.

Mareveshje bashkëpunimit me Islamic Relief Kosova Janar – Qershor 2024 për 250 pako ushqimore, dhe 300 pako mish dhe 8 frigorifera.

Nënshkrimi i Memorandumit të bashkëpunimit me Humanity First për pako ushqimore, mish për 50 familje me rastin e festës së Kurban Bajramit. Numer 16-031/01-0039556/24 data 11.06.2024.

Nënshkrimi i Bashkëpunimit të Mareveshjes me Shërbimin Sprovues të Kosovës.

Nr. 16-030/01-0039873/24 data 12.06.2024.

Nenshkrimi i Mareveshjes se Bashkëpunimit me SOS fshatrat e femijeve Kosovë me numer protokoli 16-30/01-0026042/24 data 16.04.2024. per strehimin e femijeve pa perkujdesje prinderore.

Janë mbajtur dy (2) diskutime Publike për sensibilizimin e popullatës për familjet strehuese , informimi per kriteret per aplikim dhe benefitet qe do ti gezojne nese aplikojne dhe perzgjidhen per te qene familje strehuese.

Per kete periudhe kohore kemi pasur 8 (tete) takime të mbajtura me OJQ -të qe kanë ofruar ndihma me pako ushqimore dhe veshmbathje për familjet raste sociale .

Ne baze te planit te perbashket me QPS-ne, janë realizuar ligjerata në katër (4) Shkolla të mesme të lartë për sensibilizimin e nxënësve dhe vetëdijsimin për pasojat e mundëshme nga martesat e herëshme, mbrojtja nga dhuna në baza gjinore, dhe me theks të veçantë mbrojtja e fëmijëve nga dhuna,

Gjatë periudhës kohore Janar – Qershor 2024, janë lëshuar 6 (gjashte) vërtetime për familjet e dëshmorëve Invalidë, Ushtarak dhe Civil si dhe për Viktima Civile të luftës.

Ne periudhën kohore Janar - Qershor 2024, kemi qenë të angazhuar në vizitat që kryen Komisioni tek familjet të cilat aplikojnë për pagesë të qirasë, dhe identifikimin e rasteve, të cilat jetojnë në kushte të vështira jetese.

Takime të mbajtura me OJQ-të, jane realizuar gjate kesaj peridhe kohore, takimet me donatorët, perfaqesuesit e KFOR-it, UN Women, takime paraprake per nenshkrimin e memorandumeve te bashkëpunimit me akteret e larte cekur, dy (2) diskutime publike senzibilizuese, takime të rregullta, si dhe takimet me qytetarë dhe zyrtarët e DMS dhe atyre te QPS.

Komisionit per verifikimin e Banesave te banimit Social I caktuar nga Asamblea Komunale numer 02-060/01-060/01-0006466-8/23 I dates 03.02.2023 me afat kohor dy vjecar ka kryer vizitat e

familjeve te strehuara ne banesat Sociale dhe ne kompleksin banesor ne Frasher per mundesine e evidentimit te rasteve te dyshimta dhe te keq perdorimit te tyre.

Furnizimi në kontinuitet për 268 familje/raste me pako ushqimore dhe higjienike për famljet në vështërsi. Kjo realizohet sipas kërkesave të qytetarëve të cilat i paraqesin pranë Drejtorisë së Mirëqenies Sociale. Distribuimi I pakove behet pas vlerësimi te dokumentacionit te rasteve qe kane aplikuar nga zyrtaret e DMS-se dhe gjendjes reale gjate vizitave te familjeve qe aplikojne.

Drejtoria për Mirëqenies Sociale gjatë muajit Janar – Qershor 2024 ka pranuar këto donacione:

316 Pako ushqimore, nga OJQ „Qatar Charity.

250 Pako ushqimore nga Ambasada e UAE nga Podgorica..

500 Pako ushqimore nga Ambasada e Qatarit ne Tiranë.

50 Pako ushqimore mish për Kurban Bajram OJQ Humanity First.

550 Pako ushqimore mish nga OJQ Islamic Relieff Kosova dhe 8 frigorifera.

Nga këto donacione janë ndihmuar rastet sociale dhe familjet në gjendje të vështire financiare, nenat vete ushqyese si dhe Komunitetet, familjet me persona me aftësi te kufizuara, familjet në vështirësi të Shoqatave të dala nga lufta dhe pensionistët-rastet në vështirësi te moshës 65+.

Drejtoreshë e Drejtorisë për
Mirëqenie Sociale

znj. Dr. Drita IBRAHIMI



[Handwritten signature]